



European
Union
Kosovo




Raport Hulumtues

STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI ÇËSHTJET E AFTËSISË SË KUFIZUAR

KU QËNDRON KOSOVA?

Vlerësim i legjislacionit të Kosovës në lidhje me çështjet e aftësisë së kufizuar në raport me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara



Mars 2020, Prishtinë

Autorë:

Rozafa Basha dhe Hajrulla Çeku, Development Solutions (Hulumtuesit kryesorë)

Ekipi hulumtues

Alban Bajrami, Anita Shabani, Arbër Thaçi, Ardit Berisha, Dilina Gashi, Donjeta Gjonbalaj, Endrit Temaj, Erleta Rrmoku, Fiona Maliqi, Korab Mala, Lavdrim Salihu, Metin Qestaj, Rrita Konjuhi

Hulumtimi u mbështet nga:

HANDIKOS, Departamenti i Programeve dhe Aktiviteteve

Përkthimi dhe redaktimi:

SH.P.K Babil

Dizajni, faqosja dhe shtypi

Media Press Sh.p.k

Për botuesin:

HANDIKOS në partneritet me SHKSH, SHVK, DPF & Threshold
Dardania 4/7 lam.D-2,
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 23 26 91
handikos@handi-kos.org
<http://www.handi-kos.org/>

Projekti u mbështet nga

“Promovimi gjithëpërfshirës në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel Lokal, Nacional dhe Regjional”

Projekt i financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
Zbatuar nga: Handikos, në partneritet me SHKSH, SHVK, DPF & Threshold

© Nëntor 2019 Handikos

Ky publikim mbrohet nga të drejtat e autorit. Ai mund të riprodhohet me çfarëdo metode pa pagesë apo leje paraprake për qëllime të tjera, por jo për rishitje. Për përdorim në çfarëdo rrethane tjetër, leja paraprake me shkrim duhet të merret nga botuesi.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e BE-së.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e BE-së.

Mirënjohjet

HANDIKOS në partneritet me Shoqatën Kosovare e të Shurdhërve, Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, Disability Partnership Finland, Threshold Finlandë dhe Development Solutions, dëshirojnë të falënderojnë Zyrën për Qeverisje të Mire-Zyra e Kryeministrit për mbështetjen e tyre dhe të gjithë studentet e Universitetit të Prishtinës që iu bashkuan ekipit hulumtues dhe dhanë kontributin e tyre për finalizimin e këtij projekti. Të gjithë studentët e përmendur në pjesën e kredencialeve ishin në qendër të procesit të hulumtimit, prandaj duhet të vlerësohen për këtë raport me merita të plota.

Ne gjithashtu dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për zyrën e BE-së në Kosovë, për financimin e këtij hulumtimi, si dhe stafin e tyre që në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët, stafin dhe vullnetarët nga HANDIKOS, SHVK, SHKSH, DPF, Threshold, ZQM-ZK & FKAK, e mbështeten tërë procesin e hulumtimit. Më në fund, ne gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë stafin e Projektit për mbështetjen e tyre në zhvillimin dhe redaktimin e raportit të hulumtimit.

Afrim Maliqi
Drejtor i Handikos

Përmbajtja

Mirënjohjet	4
Përmbajtja	5
Akronimet	6
1.Përmbledhja ekzekutive	7
2.Metodologjia	9
3. Standardet e vlerësuara (kategoritë dhe detyrimet)	11
1. E drejta për jetë dhe drejtësi	11
2. Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet	12
3. Qasja	13
4. Arsimi	13
5. Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja	14
6. Barazia, mos diskriminimi (gratë dhe fëmijë)	15
7. Shëndeti	16
8. Punësimi dhe kujdesi social	17
9. Pjesëmarrja publike	18
10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	19
4. Gjetjet kryesore	20
4.1. E drejta për jetë dhe drejtësi	21
4.2. Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet	22
4.3. Qasja.	23
4.4. Arsimi	24
4.5. Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja	25
4.6. Barazia, mos diskriminimi (gratë dhe fëmijë)	26
4.7. Shëndeti	27
4.8. Punësimi dhe kujdesi social	28
4.9. Pjesëmarrja publike	29
4.10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	30
5. Konkluzionet dhe Rekomandimet	31
Rekomandimi 1	31
Rekomandimi 2	31
Rekomandimi 3	31
Rekomandimi 4	32
Rekomandimi 5	32
Rekomandimi 6	32

A K R O N I M E T

HANDIKOS-Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës

SHKSH-Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

SHVK-Shoqata e të Verbërve të Kosovës

FKAK-Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

DPF-Disability Partnership Finland

ZQM-Zyra për Qeversje të Mirë

ANED- Rrjeti Akademik i Ekspertëve Evropianë (Academic Network of European Disability Experts)

KDPAK - Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

QZHQ –Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të)

PAK-Persona me Aftësi të Kufizuara

OPAK-Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar

1. Përmbledhja ekzekutive

Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (adaptuar në vitin 2006 nga Kombet e Bashkuara), përcakton detyrimet ligjore të shteteve nënshkruese për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Që Konventa të sjellë ndryshim në jetën e personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, kujdestarëve dhe komuniteteve, shtetet nënshkruese duhet ta zbatojnë atë. Kërkesë kryesore në këtë drejtim, siç përcaktohet në nenin 4, (Detyrimet e përgjithshme), është që shtetet nënshkruese të harmonizojnë legjislacionin e tyre të brendshëm me Konventën. Një nga hapat më të rëndësishëm që një shtet mund të ndërmarrë drejt zbatimit të KDPAK-së është të ndërmarrë një 'kontroll' gjithëpërfshirës - ose rishikim - për të ekzaminuar dhe për të vlerësuar ligjet ekzistuese për të identifikuar çdo fushë të mosrespektimit, për shembull nëse ka ligje diskriminuese ose boshllëqe, ku nevojiten masat e reja legjislative. Edhe në rastet kur konventat ndërkombëtare përfshihen automatikisht në legjislacionin vendor, rishikimi do të jetë i nevojshëm për të siguruar konsistencën e tërë legjislacionit, duke përfshirë edhe vetë kushtetutën, si dhe fushat specifike për sektorin si shëndetësia, punësimi dhe arsimiti, ndër të tjera.

Një instrument matës i Bashkimit Evropian, Rrjeti Akademik i Ekspertëve Evropianë për Aftësi të Kufizuara (ANED), themeluar nga Komisioni Evropian në vitin 2007, ofron mbështetje shkencore dhe këshilla për Njësitin e Komisionit Evropian për Aftësi të Kufizuara dhe Gjithëpërfshirëse. Një nga funksionet e ANED-it është të krijojë mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e ligjeve dhe politikave të BE-së që prekin personat me aftësi të kufizuara (përfshirë, për shembull, legjislacionin, komunikimet dhe rezolutat e Këshillit, Parlamentit dhe Komisionit, dhe të komiteteve relevante, etj.). Përmbledhjet rezultuese, si dhe detajet e ligjeve dhe të politikave janë në dispozicion për komunitetin e gjerë të hulumtuesve, politikë-bërësve dhe palëve të tjera të interesit përmes faqes së internetit të ANED-it (<http://www.disability-europe.net/>).

Hulumtimi, vlerëson legjislacionin aktual të Kosovës nga pikëpamja e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian, në fushat përkatëse. Vlerësimi shikon standardet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar të kodifikuar në konventat përkatëse dhe aktet ligjore, përmes kategorive të mëtuajtshme: 1. Të drejtës për jetë dhe drejtësi, 2. Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet, 3. Qasshmëria, 4. Edukimi, 5. Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizshmëria, 6. Barabarësia, mos-diskriminimi (gratë dhe fëmijët), 7. Shëndeti, 8. Punësimi dhe kujdesi social, 9. Pjesëmarrja publike, 10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë.

Më pak se një e treta (30.72%) e detyrimeve (standardeve) të vlerësuara ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar janë të përfshira plotësisht në legjislacionin e Kosovës. Pjesa tjetër, rreth 70% të detyrimeve i përkasin kategorive të vlerësimit pjesërisht të adresuara (50.00%) dhe atyre që mungojnë (19.28%). Qasja mbetet kategoria më sfiduese, me vetëm 6.77% të standardeve të përfshira plotësisht në legjislacion. Nga ana tjetër, te Pjesëmarrja publike dhe Statistikat dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar mungon niveli standardeve me 60%, gjegjësisht 100%.

¹OKB, Legjislativi për Aftësi të Kufizuara,

<https://www.un.org/esa/socdev/document/disability/Toolkit/Legislativingfordisabilityrights.pdf>

²ANED, Legjislacioni dhe Politikati e BE-së, <https://www.disability-europe.net/theme/eu-law-and-policy>

Tri kategori me vlerësim më të lartë janë: Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja (68.42% standard i plotë), Shëndeti (66.66% standard i plotë) dhe Barazia, mos-diskriminimi (gratë dhe fëmijët) (60% standard i plotë). Duhet ritheksohet se, në përgjithësi, shumica e detyrimeve (standardeve) vlerësohen si «pjesërisht të adresuara» (50.00%). Kjo do të thotë se gjysma e standardeve të vlerësuara, megjithëse janë pjesë e legjisllacionit të Kosovës, ato nuk arrijnë të përfshijnë plotësisht standardet përkatëse, duke i parandaluar kështu personat me aftësi të kufizuara t'i gëzojnë plotësisht dhe t'i ushtrojnë të drejtat e tyre përkatëse.

Ky raport u bën apel institucioneve të Kosovës t'i adresojnë të gjitha fushat përkatëse të të drejtave dhe shërbimeve të aftësisë së kufizuar, meqë ka boshllëqe të konsiderueshme ligjore. Në këtë drejtim, të dhjetë kategoritë e standardeve të aftësisë së kufizuar të vlerësuara në këtë raport duhet të jenë fusha me prioritet të institucioneve shtetërore. Por, disa fusha kërkojnë ndërhyrje urgjente, për shkak të rezultateve të dobëta të vlerësimit. Këtu hyn qasja, pjesëmarrja e publikut, statistikat, e drejta për jetë dhe drejtësi, pavarësia, privatësia, familja, jeta në komunitet, punësimi dhe kujdesi social.

Ky raport dhe raportet vijuese në vitet e ardhshme duhet të përdoren për zhvillimin e politikave dhe proceset e matjes së arritshmërisë. Qëllimi kryesor i këtij raporti është të nxjerrë në pah boshllëqet në legjisllacion dhe t'i udhëzojë institucionet shtetërore për planifikimin, hartimin dhe shpërndarjen e duhur të politikave publike për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

2. Disa fjalë rreth metodologjisë

Ky studim bën vlerësimin e legjislacionit aktual të Kosovës përkitazi me aftësinë e kufizuar nga pikëpamja e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) dhe Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian në fushat përkatëse. Ky vlerësim analizon standardet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar të kodifikuar në konventat përkatëse dhe aktet ligjore përmes kategorive të mëposhtme: 1. E drejta për jetë dhe drejtësi, 2. Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet, 3. Qasja, 4. Arsimi, 5. Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja, 6. Barazia, mos diskriminimi (gratë dhe fëmijë), 7. Shëndeti, 8. Punësimi dhe kujdesi social, 9. Pjesëmarrja publike, 10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Pjesa më thelbësore e këtij aktiviteti hulumtues ishte leximi dhe të kuptuarit më të mirë të instrumenteve përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, përpara se të ecet përpara me vlerësimin. Në fillim, ishte detyrë e secilit student, personi me aftësi të kufizuar, anëtarëve të organizatave të personave me aftësi të kufizuar / hulumtuesit, që të lexojnë me kujdes KDKPAK dhe secilin instrument të acquis-it (ose pjesët që lidhen me aftësinë e kufizuar). Për ta kuptuar më mirë standardin gjegjës të aftësisë së kufizuar, lidhjen e tij me KDKPAK dhe me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, u ndihmoi studentëve/hulumtuesve të zhvillojnë të kuptuarit më të gjerë të standardit përkatës dhe zbatimit të tij në nivel global. Pasi ishin përcaktuar QZHQ-të specifike, studenti / hulumtuesi duhej të identifikonte objektivin / objektivat specifike dhe indikatorin / indikatorët specifikë të secilit QZHQ që lidhet me instrumentin përkatës të acquis-it.

Thelbi i këtij aktiviteti ishte të vërtetohet nëse legjislacioni i Kosovës (ligjet, akte nënligjore ose aktet e tjera ligjore) i përmbushin standardet përkatëse ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar. Ky aktivitet specifik përfshinte kontrollimin përmes ligjeve specifike të aftësisë së kufizuar, ligjeve që përmbajnë dispozita që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe udhëzimeve administrative dhe rregulloreve mbi aftësinë e kufizuar. Kur nuk gjendej asnjë dispozitë, kjo gjetje cilësohej si "standardet që mungojnë". Në rastet kur kishte dispozita që adresojnë pjesërisht ose tërthorazi standardin specifik, ai kategorizohej si "pjesërisht i adresuar". Nëse standardi është plotësisht i kodifikuar në legjislacionin e Kosovës, ai u kategorizua ashtu siç duhet (standard i plotë).

Për qëllimet e këtij aktiviteti u përdorën një varg burimesh të të dhënave:

- Rrjeti Akademik i Ekspertëve Evropianë për Aftësi të Kufizuara (ANED), Shqyrtimi me shënime i legjislacionit dhe politikave të Bashkimit Evropian në lidhje me aftësinë e kufizuar, <https://www.disability-europe.net/theme/eu-law-and-policy>
- EU Acquis Communautaire, <https://eur-lex.europa.eu/homepage.html>
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK), <https://www.un.org/development/desa/disactions/convention-on-the-rights-of-persons-with-disactions.html>
- Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, <https://sustainabledevelopment.un.org/?menu=1300>
- Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës, http://www.kryeministrit.net/repository/docs/STRATEGJIA_NACIONALE_PER_TE_DREJTAT_E_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE..._Shq+Ser+Ang.pdf
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net> (për ligje dhe akte nënligjore)
- Faqet e internetit të ministrive të linjës, <https://www.rks-gov.net> (për akte nënligjore)

- HANDIKOS, Përmbledhje Legjislacioni mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, http://www.handikos.org/repository/docs/PERMLEDHJE_LEGJISLACIONI_MBI_TE_DREJTA_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE_KUFIZUARA_628624.pdf

Tabela në vijim shpjegon logjikën e matricës të përdorur për vlerësimin e secilit detyrim ndërkombëtar të aftësisë së kufizuar (standard) si pjesë e këtij studimi.

Kategoria	Detyrimet	UNCRPDEU	EU Acquis	SDG/QZHQ	Legjislacioni i Kosovës	Vlerësimi
Grupet e standardeve të vlerësuara	Standardet ndërkombëtare (duke u bazuar në KDPAK)	Lidhja mes çështjeve / standardeve specifike të aftësisë së kufizuar dhe neneve të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara	Emri i plotë i instrumentit ligjor dhe komentet përkatëse	Çështja specifike e aftësisë së kufizuar është e lidhur me QZHQ (të) dhe objektivat dhe treguesit përkatës	Ligjet specifike, aktet nënligjore ose aktet e tjera ligjore që adresojnë çështjen / standardin përkatës të aftësisë së kufizuar (emri,	Standard që mungon I adresuar pjesërisht Standard i plotë

Pjesë e këtij aktiviteti ishin gjithsej katër ekipe studentësh / hulumtuesish nën mbikëqyrjen e hulumtuesve kryesorë. Projekti realizoi partneritet me këto departamente të Universitetit të Prishtinës: Juridik, Sociologji, Punë Sociale, Shkenca Politike dhe Antropologji. Angazhimi i studentëve / hulumtuesve nisi në fund të korrikut dhe zgjati deri në fund të shtatorit. Fillimisht, studentët vijuan një takim orientues për të parë pasqyrën e plotë të aktivitetit, metodologjisë dhe pritjeve. Të gjithë studentët / hulumtuesit u monitoruan nga afër nga hulumtuesit kryesorë dhe ekipi i projektit.

3. Standardet e vlerësuara (kategoritë dhe detyrimet)

Dokumenti / konventa referuese ndërkombëtare për përcaktimin e detyrimeve për aftësinë e kufizuar për këtë studim ishte Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Detyrimet (standardet) ndërkombëtare për aftësinë e kufizuar për nevojat e këtij studimi janë grupuar në dhjetë kategori: 1. E drejta për jetë dhe drejtësi, 2. Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet, 3. Qasja, 4. Arsimi, 5. Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja, 6. Barazia, mos-diskriminimi (gratë dhe fëmijë), 7. Shëndeti, 8. Punësimi dhe kujdesi social, 9. Pjesëmarrja publike, 10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Legjislacioni i Kosovës është vlerësuar duke u bazuar në nivelin e përmbushjes së secilit detyrim (standard) të aftësisë së kufizuar sipas dhjetë kategorive gjegjëse. Ky studim ka përdorur metodologji të vlerësimit me tre nivele: të plotë, të pjesshëm dhe jo të plotë. Fushëveprimi i këtij studimi ishte të kontrollonte nivelin e përfshirjes së standardeve përkatëse në legjislacionin e Kosovës, dhe jo zbatimin e tyre aktual. Çështja e zbatimit të tyre duhet të jetë pjesë e angazhimit vijues të HANDIKOS-it dhe organizatave të tjera që merren me çështjet e aftësive të kufizuara në Kosovë.

1. E drejta për jetë dhe drejtësi—në këtë kategori ishin vlerësuar këto obligime (standarde), nga të cilat vetëm 21.42% janë përfshirë plotësisht në legjislacionin e Kosovës:

- 1.1. E drejta për jetë dinjitoze-nën standardin që lidhet me parimin (a), në nenin 3 të KDPAK, që kërkon respekt për dinjitetin e qenësishëm, autonominë personale dhe pavarësinë e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK).
- 1.2. Mbrojtja dhe siguria e personave me aftësi të kufizuara në rastet e rrezikut, konfliktit, krizës humanitare dhe fatkeqësive natyrore-nën standardi në lidhje me nenin 11 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë, të marrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen dhe sigurinë e PAK, në rastet e krizave humanitare dhe fatkeqësive natyrore.
- 1.3. Kapaciteti ligjor mbi baza të barabarta me të tjerët-nën standardi në lidhje me nenin 12 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë të drejta për njohje të barabartë para ligjit për PAK.
- 1.4. Mundësia e hyrjes në veprim ligjor mbi baza të barabarta me të tjerët (p.sh. martesë, llogaria bankare, pasuria)-nën standardi në lidhje me parimet 3,4 dhe 5 të nenit 12 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë, të ndërmarrin të gjitha masat dhe ofrojnë mbështetjen e nevojshme për PAK për të ushtruar plotësisht aftësinë e tyre ligjore.
- 1.5. Mbrojtje efektive nga abuzimi me mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara në kapacitet ligjor-nën standardi që lidhet me nenin 12 të KDPAK.
- 1.6. Korrigjimi / dëmshpërblimi në rast të mohimit të së drejtës së zotësisë juridike-nën standardi që lidhet me nenin 12 të KDPAK.
- 1.7. Mekanizmat e mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e së drejtës për zotësi juridike- nën standardi që lidhet me nenin 12 të KDPAK.
- 1.8. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në proceset ligjore përmes gjuhës së shenjave, Braille-nën standardi që lidhet me nenin 13 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë qasje të plotë për PAK, në procedura gjyqësore.
- 1.9. Qasje e lehtë fizike në të gjitha lehtësirat e sistemit të drejtësisë- nën standardi që lidhet me nenin 13 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë qasje të plotë për PAK, në procedura gjyqësore.

2.Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në bashkësi përfshiu një varg standardesh, nga të cilat vetëm 27.27% janë përfshirë plotësisht në legjislacionin e Kosovës:

- 2.1.Zgjedhja e lirë e vendit të banimit dhe njerëzve për të bashkëjetuar-nën standardi që lidhet me parimin (a) të nenit 19 të KDPAK, kërkon nga shtetet palë të njohin të drejtën e barabartë të PAK-ve për të zgjedhur vendin e tyre të banimit dhe jetesën në komunitet, në baza të barabarta me të tjerët.
- 2.2.Masat mbrojtëse për parandalimin e imponimit të aranzhimeve të banimit dhe jetesës-nën standardi që lidhet me parimin (a) të nenit 19 të KDPAK, që kërkon ndër të tjera, edhe marrjen e masave për parandalimin e imponimit të marrëveshjeve të jetesës për PAK.
- 2.3.Mundësitë për jetë të pavarur- nën standardi që lidhet me parimet e nenit 19 të KDPAK, kërkon nga shtetet palë të marrin të gjithë masat e nevojshme për të ju mundësuar PAK-ve, të jetojnë në mënyrë të pavarur.
- 2.4.Qasja në shërbime brenda shtëpisë dhe komunitetit (ndihmë personale, të ardhurat, përfshirja në komunitet)-nën standard që lidhet me parimet (b) dhe (c) të nenit 19 të KDPAK, kërkon nga shtetet palë të sigurojnë sisteme mbështetëse në komunitet për PAK, për të jetuar në mënyrë të pavarur.
- 2.5.Shërbimet e komunitetit dhe lehtësirat për publikun e gjerë të ofrohen në mënyrë të barabartë edhe për PAK (dhe pasqyrojnë nevojat e tyre)- nën standard që lidhet me parimet (b) dhe (c) të nenit 19 të KDPAK, kërkon nga shtetet palë të sigurojnë sisteme mbështetëse në komunitet për PAK, për të jetuar në mënyrë të pavarur.
- 2.6.Programet e mobilitetit personal që sigurojnë ndikim vendimtar të personave me aftësi të kufizuara në zbatimin e tyre- nën standardi që lidhet me parimet e nenit 20 të KDPAK, u kërkon shteteve palë të sigurojnë sisteme mbështetëse në komunitet për PAK, për të jetuar në mënyrë të pavarur.
- 2.7.Mbrojtja e privatësisë së informacionit personal, mjekësor dhe rehabilitues të personave me aftësi të kufizuara mbi bazë të barabartë me të tjerët-nën standardi lidhur me parimet e nenit 22 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale, shëndetësore dhe të dhënave tjera për PAK.
- 2.8.Personat me aftësi të kufizuara në moshën e martesës mund të krijojnë familje me pëlqimin e ndërsjellë të partnerëve-nën standardi që lidhet me parimet e nenit 23 të KDPAK, kërkon nga shtetet palë që të ndërmarrin të gjithë masat në mënyrë që PAK, të martohen në moshën e martesës në bazë të pëlqimit të lirë, të plotë dhe të ndërsjellë, përmes së cilës sigurojnë respekt për shtëpinë dhe familjen e PAK-ve.
- 2.9.E drejta për të vendosur lirshëm për numrin dhe kohën e pasurit fëmijë-nën standardi në lidhje me parimin (b) të nenit 23 të KDPAK, që u kërkon shteteve palë të marrin të gjithë masat që PAK të ushtrojnë të drejtën e tyre të plotë për të vendosur për numrin e fëmijëve dhe kohën kur dëshirojnë ti kenë fëmijët.
- 2.10.Informacioni adekuat rreth planifikimit të familjes dhe shëndetit riprodhues-nën paragrafi që lidhet me parimin (b) të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë, të marrin të gjithë masat me qëllim që PAK të kenë qasje të plotë në edukimin mbi planifikimin familjarë.

3. Qasja është ndër kategoritë dhe standardet më të rëndësishme, ku për qëllimet e këtij studimi përfshihen detyrimet e mëposhtme (vetëm 6.77% të përfshira plotësisht në legjislacionin e Kosovës):

- 3.1. Qasja e barabartë në mjedis fizik, transport, TIK dhe lehtësira dhe shërbime të tjera-nën standard që lidhet përgjithësisht me nenet 3 dhe 4 dhe veçanërisht me të gjithë parimet e nenit 9 të KDPAK, që u kërkon shteteve palë të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qasshmërinë në mjedise me ndërtesa, mallra, shërbime dhe TIK, për PAK-ët.
- 3.2. Standardet minimale dhe udhëzimet e qasjes-nën standard që lidhet me parimin 2 (a) të nenit 9 të KDPAK, kërkojnë nga shtetet palë të marrin të gjithë masat e duhura për të hartuar standardet minimale dhe udhëzuesit për të siguruar qasje pa pengesa në mallra, shërbime dhe objekte publike për PAK-ët.
- 3.3. Kompanitë private heqin barrierat dhe nuk vendosin të reja- standarde që lidhen me të gjithë parimet e pikës 2 (b) të nenit 9 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që subjektet private që ofrojnë shërbime publike të jenë pa pengesa. Përdorimi i mekanizmave në dispozicion në rastet e mohimit të hyrjes.
- 3.4. Trajnimi i palëve të interesuara relevante për qasjen e personave me aftësi të kufizuara-nën standardin në lidhje me të gjithë parimet e pikës 2 (c) të nenit 9 të KDPAK, që shtetet palë, të ofrojnë trajnime të palëve të interesuara për çështje të qasjes.
- 3.5. Format për lehtësimin e komunikimit përmes Braille-it dhe udhëzuesve të tjerë (interpretët)- standarde që lidhen me të gjithë parimet nga pikat 2 (d), (e) dhe (f) të nenit 9 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë mundësinë e përdorimit të mjeteve përmes gjuhës Braille për të siguruar informacionin, si dhe sigurimin e ndihmës së drejtpërdrejtë dhe të ngjashme kur PAK-ët, të hyjnë në hapësirat të ndërtesave.
- 3.6. Qasja në informacion, sisteme, internet- standarde që lidhet me të gjitha parimet nga pikat 2 (f), 2 (g) dhe 2 (h), të nenit 9 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të promovojnë qasje për PAK në informacion dhe komunikim.
- 3.7. Kërkesat e qasjes janë pjesë përbërëse e projekteve ndërtimore që nga faza e projektimit- standarde që lidhen me parimet nga pika 1 (f) të nenit 4 dhe parimet nga pika 2 (a) të nenit 9 të KDPAK, për të zhvilluar standarde dhe udhëzime minimale për të siguruar qasje pa pengesa në mallra, shërbime dhe lehtësira publike për PAK.
- 3.8. Organizatat e personave me aftësi të kufizuara konsultohen lidhur me standardet dhe normat e qasjes. Shërbimet e mediave janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara-nën standarde të lidhura me parimin (d) të nenit 21 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të inkurajojnë ofruesit e mediave masive që t'i bëjnë shërbimet e tyre të disponueshme në formate të përshtatshme për PAK.

4. Arsimi është ndër kategoritë me rezultate të moderuara. Rreth 42% e standardeve të mëposhtme të aftësisë së kufizuar janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës:

- 4.1. E drejta për arsim gjithëpërfshirës-- standarde që lidhet me të gjitha parimet e nenit 24 të KDPAK, që u kërkon shteteve pale të marrin të gjitha masat për të siguruar që PAK të kenë qasje të plotë në të gjitha nivelet e arsimit brenda sistemit të përgjithshëm, në mënyrë të barabartë me të tjerët.
- 4.2. Parandalimi i mohimit të së drejtës së arsimit në bazë të aftësisë / aftësisë së kufizuar.

- 4.3. Nxënësit me aftësi të kufizuara ndjekin mësim të rregullta në shkollë- standarde të lidhura me parimin 2 (a) të nenit 24 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë shtetërore të organizojnë arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm.
- 4.4. Detyrimet e shkollave për të përmirësuar qasjen për nxënësit e shkollës me aftësi të kufizuara, standarde të lidhura me parimin 2 (c) të nenit 24 të KDPAK, që u kërkon shteteve palë të sigurojnë strehim të arsyeshëm në ambiente shkollore për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- 4.5. Parandalimi i diskriminimit të vajzave me aftësi të kufizuara në qasjen në arsim.
- 4.6. Mbështetja individuale për nxënësit dhe studentët-standarde lidhur me parimin 2 (e) të nenit 24 të KDPAK, që kërkon mbështetje efektive individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara që do të maksimizojnë zhvillimin e tyre akademik dhe shoqëror.
- 4.7. Punësimi i mësuesve (duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara) që zotërojnë gjuhën e shenjave dhe gjuhën Braille-- nën standarde në lidhje me parimin 4 të nenit 24 të KDPAK, që kërkon që shtetet palë të organizojnë punësimin e mësuesve, përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuara për të siguruar arsimimin e duhur për fëmijët me aftësi të kufizuara Brenda sistemit të përgjithshëm të arsimit.
- 4.8. Trajnimi i mësuesve dhe profesionistëve të tjerë për arsim gjithëpërfshirës- nën standardin në lidhje me parimin 4 të nenit 24 të KDPAK, që u kërkon palëve shtetërore të organizojnë trajnime të stafit mësimor për të siguruar arsimim të duhur për fëmijët me aftësi të kufizuara brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm.

5. Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizshmëria përfshiu një varg standardesh, nga të cilat mbi dy të tretat (68.42%) janë përfshirë plotësisht në legjislacionin e Kosovës:

- 5.1. Liria dhe siguria zbatohen mbi baza të barabarta me të tjerët- standarde që lidhen me nenin 14 të KDPAK, që u kërkon shteteve palë të sigurojnë të drejtën e lirisë dhe sigurinë e PAK në baza të barabarta me të tjerët.
- 5.2. Parandalimi i palëve të treta (duke përfshirë anëtarët e familjes) nga institucionalizimi i personave me aftësi të kufizuara mbi bazën e aftësisë së kufizuar- nën standardin në lidhje me parimin 1 (b) të nenit 14 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që PAK nuk privohen nga liria bazuar në aftësinë e kufizuar.
- 5.3. Kompensimi për personat me aftësi të kufizuara të privuar nga liria në bazë të aftësisë së kufizuar.
- 5.4. Akomodimi i arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara të privuar ligjërisht nga liria- standarde në lidhje me parimin 2 të nenit 14 të KDPAK, që kërkojnë nga shtetet palë, të sigurojnë strehim të arsyeshëm për PAK-të që janë privuar nga liria në bazë të aftësisë së kufizuar të tyre.
- 5.5. Parandalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor- nën standardi në lidhje me nenin 15 të KDPAK, që u kërkon shteteve palë të sigurojnë lirinë nga torturat ose trajtimin çnjerëzor të PAK-ve.
- 5.6. Personat me aftësi të kufizuara nuk do t'i nënshtrohet eksperimenteve mjekësore apo shkencore pa pëlqimin e tyre- nën standardin në lidhje me parimin 1, të nenit 15 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që PAK nuk do t'i nënshtrohet eksperimenteve mjekësore dhe shkencore pa pëlqimin e tyre.

- 5.7. Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi brenda dhe jashtë shtetësisë- standarde në lidhje me të gjitha parimet e nenit 16 të KDPAK, që kërkojnë nga shtetet palë të sigurojnë që PAK është i lirë nga çdo formë dhune dhe shfrytëzimi brenda dhe jashtë shtetësisë.
- 5.8. Mbrojtja përkitazi me moshën dhe gjininë për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet / ndihmësit-standarde lidhur me parimin 2, të nenit 16 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë mbrojtje të ndjeshme ndaj moshës, gjinisë dhe aftësisë së kufizuar për PAK dhe familjet e tyre.
- 5.9. Monitorim efektiv i të gjitha lehtësirave dhe programeve që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara nga autoritetet e pavarura- standarde që lidhen me parimin 3 të nenit 16 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë monitorimin e programeve dhe lehtësive për PAK nga autoritetet e pavarura.
- 5.10. Rehabilitimi fizik, kognitiv dhe psikologjik dhe riintegrimi shoqëror i personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë vuajtur abuzime- nën standarde në lidhje me nenin 17 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë masa të përshtatshme për të siguruar rehabilitimin dhe integrimin shoqëror të viktimave të abuzimit të PAK.
- 5.11. Respektimi i integritetit fizik dhe mendor të personave me aftësi të kufizuara mbi bazë të barabartë me të tjerët- standarde në lidhje me të gjitha parimet e nenit 16 të KDPAK, që kërkojnë që shtetet palë të sigurojnë respektimin e integritetit fizik dhe mendor të PAK-ve, në baza të barabarta me të tjerët.
- 5.12. E drejta për nënshtetësi dhe mosprivimi nga shtetësia në bazë të aftësisë së kufizuar- nën standarde në lidhje me nenin 18 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që PAK kanë të drejtë në shtetësi/kombësi dhe si të tillë kanë lirinë e lëvizjes ndërmjet vendeve. Nuk duhet të privohen nga e drejta e kombësisë bazuar në aftësinë e kufizuar.

6.Barazia, mosdiskriminimi (gratë dhe fëmijët) është një kategori shumë e rëndësishme që përqendrohet te gratë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara (shumica e standardeve 60%), të përfshira në legjislacionin e Kosovës:

- 6.1. Ndalimi i të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara-standarde në lidhje me parimin 1 të nenit 6 të KDPAK, që shtetet palë të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të gëzojnë në maksimum të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.
- 6.2. Liria, siguria dhe autonomia e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara-- standarde që lidhen me parimet e pikas (g) të nenit 3 dhe nenit 14 të KDPAK, që kërkon që shtetet palë të garantojnë lirinë dhe sigurinë e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët.
- 6.3. Heqja e barrierave në zhvillimin ekonomik dhe personal të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Qasja e garantuar në shërbime shëndetësore për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara- nën standarde në lidhje me nenin 25 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që të gjitha gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në shërbimet shëndetësore në bazë të barabartë me të tjerët.
- 6.4. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zhvillimin e politikave të aftësisë së kufizuar.

- 6.5. Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk do t'i nënshtrohen shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit-standardi i lidhur me parimin 5 të nenit 16 të KDPAK, që shtetet palë të sigurojnë që legjislacioni dhe politikat e përqendruara ndaj fëmijëve të sigurojnë raste të të gjitha formave të dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara të identifikohen dhe penalisht.
- 6.6. Regjistrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara menjëherë pas lindjes-nën standarde në lidhje me parimin 2 të nenit 18 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë regjistrimin e menjëhershëm pas lindjes së të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- 6.7. E drejta për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara-- standarde në lidhje me parimin e nenit 24 (a) të nenit 24 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshihen në arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas dhe arsimin e mesëm.
- 6.8. E drejta për shërbime shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara- standarde që lidhen me nenin 25 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në shërbimet shëndetësore në baza të barabarta me të tjerët.
- 6.9. Pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive dhe rekreative--standarde lidhur me parimin 5 (d) të nenit 30 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që fëmijët me aftësi të kufizuara të shijojnë lojën dhe rekreacionin në baza të barabarta me fëmijët e tjerë.

7.Shëndeti është ndër kategoritë me numrin më të madh të detyrimeve (standardeve) ndërkombëtare të përfshira në legjislacionin e Kosovës (dy të tretat, 66.66%):

- 7.1. Objektet dhe shërbimet shëndetësore funksionale me programe dhe shërbime të përshtatshme për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara- nën standarde të lidhura me të gjithë parimet e nenit 25 të KDPAK, që kërkon që shtetet palë të sigurojnë shërbime shëndetësore të përshtatshme dhe të arritshme për PAK.
- 7.2. Objektet dhe shërbimet shëndetësore të qasshme dhe jodiskriminuese ndaj grupeve të pafavorizuara-
- 7.3. standarde të lidhura me të gjithë parimet e nenit 25 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë shërbime shëndetësore të përshtatshme dhe të arritshme për PAK.
- 7.4. Shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara janë të përballueshme- nën standarde në
- 7.5. lidhje me parimin (a) të nenit 25 të KDPAK, që kërkon që shtetet palë të sigurojnë shërbime shëndetësore të përballueshme për PAK.
- 7.6. Shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara ofrohen mbi parimet etike dhe me respektimin e plotë të kulturës së individit, minoriteteve, popujve dhe komuniteteve, gjinisë dhe të tjera- nën standarde në lidhje me parimin (d) të nenit 25 të KDPAK, që kërkon që shtetet palë të garantojnë standarde të larta etike nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore drejt PAK.
- 7.7. Shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara ofrohen me cilësi adekuate shkencore dhe mjekësore, si dhe me sasi përkatëse- nën standarde në lidhje me parimin (b) të nenit 25 të KDPAK.

- 7.8. Zhvillimi i programeve rehabilituese për të gjitha grupet e aftësisë së kufizuar--standarde të lidhura me të gjithë parimet e nenit 26 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të zhvillojnë programe të rehabilitimit dhe rehabilitimit për PAK.
- 7.9. Të gjithë personat me aftësi të kufizuara në nevojë duhet të kenë qasje në shërbimet e rehabilitimit-standarde që lidhen me të gjithë parimet e nenit 26 të KDPAK, që kërkon që shtetet palë të zhvillojnë programe të rehabilitimit dhe rehabilitimit për PAK.
- 7.10. Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre marrin pjesë në zhvillimin dhe organizimin e programeve dhe shërbimeve të rehabilitimit-standarde të lidhura me të gjithë parimet e nenit 26 të KDPAK, që kërkon nga shtetet palë të ofrojnë programe rehabilitimi dhe rehabilitimi për PAK.
- 7.11. Shërbimet e rehabilitimit ofrohen në komunitetin lokal ku jeton personi me aftësi të kufizuara- nën standardin në lidhje me parimin 1 (b) të nenit 26 të KDPAK, që kërkon që shtetet palë të zhvillojnë programe të rehabilitimit sa më afër të jetë e mundur me komunitetin e PAK.
- 7.12. Zhvillimi dhe vlerësimi i programeve të rehabilitimit merr parasysh ekspertizën e ofruar nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara-standarde në lidhje me parimin 2 të nenit 26 të KDPAK, që kërkon që shtetet palë të zhvillojnë programe rehabilitimi për PAK.

8. Punësimi dhe kujdesi shoqëror është vlerësuar përmes detyrimeve (standardeve) vijuese, nga të cilat vetëm pak më shumë se një e treta (38,88%), e tyre është përfshirë në legjislacionin e Kosovës:

- 8.1. E drejta për të fituar të ardhura për jetesë nga një punë që u siguron qasje personave me aftësi të kufizuara- nën standardin në lidhje me parimet e nenit 27, i cili kërkon që shtetet palë të njohin të drejtën e PAK për të punuar dhe për të fituar jetesën përmes punës së zgjedhur lirisht.
- 8.2. Ndalimi i diskriminimit në punësim në bazë të aftësisë së kufizuar-standarde në lidhje me parimin 1 (a) të nenit 27, i cili kërkon që shtetet palë të ndalojnë diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar në lidhje me punën, punësimin dhe avancimin, etj.
- 8.3. Mundësitë e barabarta në kushte të punës, pagesë, karrierë dhe mbrojtje nga ngacmimi-standarde në lidhje me parimin 1 (b) të nenit 27, që kërkon që punëdhënësit të trajtojnë në mënyrë të barabartë punonjësit me aftësi të kufizuara në lidhje me pagesën, mbrojtjen nga diskriminimi dhe kushtet e punës
- 8.4. Qasje efektive e personave me aftësi të kufizuara në programet e arsimit profesional, mundësitë e punësimin dhe zhvillimin e karrierës- nën standardin në lidhje me parimin 1 (d) të nenit 27, që kërkon shteteve palë të sigurojnë që PAK të përfshihet në trajnime profesionale dhe teknike në baza të barabarta me të tjerët.
- 8.5. Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat- nën standardin në lidhje me parimet 1 (g) dhe (h) të nenit 27, që kërkon punëdhënësit në sektorin publik dhe privat të punësojnë PAK
- 8.6. Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga puna e detyruar-standarde që lidhet me parimin 2 të nenit 27, që kërkon nga shtetet palë të sigurojnë që askush, përfshirë PAK, nuk i nënshtrohet skllavërisë dhe punës së detyruar.

- 8.7. Garantimi i standardit adekuat të jetesës për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre (ushqim, veshmbathje, strehim)- nën standarde në lidhje me parimin 1 të nenit 28, që kërkon që shtetet palë të garantojnë që PAK kanë standarde adekuate të jetesës në baza të barabarta me të tjerët.
- 8.8. Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet e ujit të pijshëm-standarde në lidhje me parimin 2 (a) të nenit 28, që kërkon nga shtetet palë të garantojnë qasje në ujë të pijshëm e të pastër për PAK.
- 8.9. Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht e grave, vajzave dhe e të moshuarve me aftësi të kufizuara, në programet e përkujdesjes sociale dhe zbutjes së varfërisë-nën standardin në lidhje me parimin 2 (b) të nenit 28, duke kërkuar nga shtetet palë të garantojnë qasje në programe të mbrojtjes sociale dhe uljes së varfërisë për gratë, fëmijë dhe popullsi në moshë me aftësi të kufizuara.
- 8.10. Mbështetje financiare dhe shërbimet e tjera për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e varfra- standarde që lidhen me parimin 2 (c) të nenit 28, duke kërkuar nga shtetet palë të garantojnë qasje në ndihmë financiare, kujdes për respektin dhe çështje të natyrave të ngjashme me atë të PAK-ve që jetojnë në varfëri.
- 8.11. Qasja e personave me aftësi të kufizuara në programet e strehimit social- standarde që lidhet me parimin 2 (d) të nenit 28, që kërkon nga shtetet palë të garantojnë qasjen e PAK në programet e strehimit në baza të barabarta me të tjerët.
- 8.12. Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në programet e pensionit dhe benefitet- standarde që lidhen me parimin 2 (e) të nenit 28, duke kërkuar nga shtetet palë të garantojnë qasje në programet e pensionit të PAK-ve në baza të barabarta me të tjerë.

9. Pjesëmarrja publike mbetet ndër kategoritë më sfiduese e standardeve të aftësisë së kufizuar, ku vetëm 20% e detyrimeve të mëposhtme janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës:

- 9.1. Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e jetës politike dhe publike mbi baza të barabarta me të tjerët (e drejta e votës dhe e zgjedhjes)- nën standarde në lidhje me të gjitha parimet e nenit 29, që kërkojnë që shtetet palë të garantojnë që PAK gëzojnë plotësisht mundësi për të marrë pjesë në jetën politike.
- 9.2. Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë mjedis mbështetës për pjesëmarrje të plotë dhe jo diskriminuese në punët publike- nën standarde në lidhje me parimin (b) të nenit 29, duke kërkuar që shtetet palë të garantojnë një mjedis që siguron që PAK, të gëzojnë mundësi për të marrë pjesë në punët publike në baza të barabarta me të tjerët.
- 9.3. Qasja e personave me aftësi të kufizuara në materialin kulturor- nën standarde në lidhje me parimin 1 (a) të nenit 30, duke kërkuar nga shtetet palë të garantojnë PAK për qasje në materialin kulturor në baza të barabarta me të tjerët.
- 9.4. Qasja e personave me aftësi të kufizuara në programe televizive, filma, teatër dhe aktivitete të tjera kulturore-nën standarde në lidhje me parimin 1 (b) të nenit 30, që kërkon që shtetet palë të garantojnë PAK, qasje në programet televizive dhe aktivitete të tjera kulturore në baza të barabarta me të tjerët.

9.5. Qasja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet dhe monumentet e trashëgimisë kulturore- standarde që lidhen me parimin 1 (c) të nenit 30, që kërkon nga shtetet palë të garantojnë PAK për qasje në trashëgimi kulturore jo-materiale dhe të prekshme në baza të barabarta me të tjerët.

10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar është kategoria më e dobët në mesin e dhjetë kategorive të vlerësuara në këtë studim. Asnjë nga standardet e mëposhtme nuk është pjesë e legjislacionit të Kosovës:

10.1. Mbledhja, analizimi dhe publikimi i të dhënave statistikore mbi gjendjen e personave me aftësi të kufizuara- nen standard në lidhje me nenin 31, duke kërkuar që shtetet palë të sigurojnë mbledhjen e informacionit, statistikave dhe të dhënave kërkimore.

10.2. Programet e zhvillimit ndërkombëtar janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara- nën standarde në lidhje me parimin neni 32, që kërkojnë nga shtetet palë të garantojnë që PAK, të kenë qasje në programet e bashkëpunimit ndërkombëtar në baza të barabarta me të tjerët.

10.3. Sigurimi i mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve përmes ndarjes dhe shkëmbimit të informacionit, trajnimit dhe praktikave më të mira- standarde që lidhen me parimin 1 (b) të nenit 32, duke kërkuar që shtetet palë të garantojnë qasjen e PAK-ve, dhe të mbështesin programet e ngritjes së kapaciteteve të së njëjtës.

10.4. Lehtësimi i bashkëpunimit në hulumtime dhe qasja në njohuritë shkencore dhe teknike- substanca standarde në lidhje me parimin 1 (c) të nenit 32, duke kërkuar që shtetet palë të lehtësojnë kërkimin dhe hyrjen në bashkëpunim shkencor për PAK.

4. Gjetjet kryesore

Më pak se një e treta (30.72%) e detyrimeve (standardeve) të vlerësuara ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar janë përfshirë plotësisht në legjislacionin e Kosovës. Pjesa tjetër e rreth 70% të detyrimeve i përkasin kategorive të vlerësimit pjesërisht të adresuara (50.00%) dhe atyre në mungesë (19.28%). Qasja mbetet kategoria më sfiduese, me vetëm 6.77% të standardeve të përfshira plotësisht në legjislacion. Nga ana tjetër, te Pjesëmarrja publike dhe Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar mungon niveli standard me 60%, gjegjësisht 100%. Tri kategori me vlerësim më të lartë janë: Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja (68.42% standard i plotë), Shëndeti (66.66% standard i plotë) dhe Barazia, mos diskriminimi (gratë dhe fëmijët) (60% standard i plotë). Duhet vënë në pah se, në përgjithësi, shumica e detyrimeve (standardeve) vlerësohen si "pjesërisht të adresuara" (50.00%). Kjo do të thotë se gjysma e standardeve të vlerësuara, megjithëse janë pjesë e legjislacionit të Kosovës, ato nuk përfshihen plotësisht në standardet përkatëse, duke i parandaluar kështu personat me aftësi të kufizuara t'i gëzojnë plotësisht dhe t'i ushtrojnë të drejtat e tyre përkatëse.

Kategoria	Standard i plotë	I adresuar pjesërisht	Standardi që mungon
<i>E drejta për jetë dhe drejtësi.</i>	21.42%	64.29%	14.28%
<i>Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet</i>	27.27%	54.54%	18.18%
<i>Qasja</i>	6.77%	79.67%	13.55%
<i>Arsimi</i>	41.66%	50%	8.33%
<i>Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja</i>	68.42%	----	31.57%
<i>Barazia, mosdiskriminimi (gratë dhe fëmijë)</i>	60%	40%	----
<i>Shëndeti</i>	66.66%	8.33%	25%
<i>Punësimi dhe kujdesi social</i>	38.88%	44.45%	16.66%
<i>Pjesëmarrja publike</i>	20%	20%	60%
<i>Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar</i>	----	----	100%

Rezultati i Vlerësimit të Kategorive

4.1.E drejta për jetën dhe drejtësi

Vlerësimi i së drejtës për jetën dhe drejtësi tregoi se vetëm 21.42% e detyrimeve (standardeve) janë përfshirë plotësisht në legjislacionin e Kosovës, ndërsa afër 80% mbeten pjesërisht të adresuara ose mungojnë.

Standardet e Vlerësuara	E drejta për jetën dhe drejtësi
Vlerësimi	<i>Vlerësimi për nen standarde</i>
Standard i plote (21.42 % në pajtueshmëri)	E drejta për jetë dinjitoze
	Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në proceset ligjore përmes gjuhës së shenjave, Braille
Standard i adresuar pjesërisht (64.29% pjesërisht në pajtueshmëri)	Mbrojtja dhe siguria e personave me aftësi të kufizuara në rastet e rrezikut, konfliktit, krizës humanitare dhe katastrofës natyrore
	Mundësia e hyrjes në veprim ligjor mbi baza të barabarta me të tjerët (p.sh. martesë, llogaria bankare, pasuria)
	Mbrojtje efektive nga abuzimi me mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara në kapacitetet ligjor
	Korrigjimi / dëmshpërblimi në rast të mohimit të së drejtës së zotësisë juridike
	Mekanizmat e mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e së drejtës për zotësi juridike
Standardi që mungon (14.28% mungojnë)	Kapaciteti ligjor mbi baza të barabarta me të tjerët
	Qasje e lehtë fizike në të gjitha lehtësirat e sistemit të drejtësisë

4.2.Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në kategoritë e komunitetit

Vlerësimi i Kategorive **Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në kategoritë e komunitetit** përfshin një varg detyrimesh (standarde) në lidhje me familjen dhe jetën e komunitetit. Më shumë se gjysma e standardeve në këtë kategori janë adresuar pjesërisht në legjislacionin e Kosovës (54.54%), ndërsa 27.27% tyre janë plotësisht e të kodifikuara.

Standardet e Vlerësuara	Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në kategoritë e komunitetit
Vlerësimi	Vlerësimi për nen standarde
Standard i plotë (27.27 % në pajtueshmëri)	Shërbimet e komunitetit dhe lehtësirat për publikun siguron barazi për personat me aftësi të kufizuara (dhe pasqyrojnë nevojat e tyre)
	Qasja në shërbime brenda shtëpisë dhe komunitetit (ndihma personale, të ardhurat, përfshirja në komunitet)
Standard i adresuar pjesërisht (54.54 % pjesërisht në pajtueshmëri)	Masat mbrojtëse për parandalimin e imponimit të aranzhimeve të banimit dhe jetesës (legjislacioni / ligji specifik është i paplotë meqë nuk përmend në veçanti personat me aftësi të kufizuara dhe nuk përmend kriteret e specifikuar nga KDPAK-ja)
	Mundësitë për jetë të pavarur
	Mbrojtja e privatësisë së informacionit personal, mjekësor dhe rehabilitues të personave me aftësi të kufizuara mbi bazë të barabartë me të tjerët (asnjë referencë specifike të mbrojtjes së privatësisë së personave me aftësi të kufizuara)
	Personat me aftësi të kufizuara në moshën e martesës mund të krijojnë familje me pëlqimin e ndërsjellë të partnerëve (asnjë referencë specifike të së drejtës së personave me aftësi të kufizuara për të krijuar familje)
	E drejta për të vendosur lirshëm për numrin e ndarjes së fëmijëve (asnjë referencë specifike të së drejtës së personave me aftësi të kufizuara për të vendosur lirshëm për numrin e ndarjes së fëmijëve)
	Informacioni adekuat rreth planifikimit të familjes dhe shëndetit riprodhues (ligji për familjen përqendrohet në martesë, detyra dhe obligime të partnerëve, dhe nuk përfshin planifikimin, kujdesin dhe shëndetin riprodhues të personave me aftësi të kufizuara)
	Standardi që mungon (18.19 % mungojnë)
	Programet e mobilitetit personal që sigurojnë ndikim vendimtar të personave me aftësi të kufizuara në zbatimin e tyre

4.3. Qasja

Qasja është ndër sfidat më të mëdha me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, e që gjithashtu shënon rezultate të dobëta te vlerësimi ligjor. Vetëm 6.77% e detyrimeve në këtë kategori vlerësohen si "standarde të ndërsa shplota", umica e tyre (rreth 80%) adresohen pjesërisht.

Standardet e Vlerësuara	Qasja
Vlerësimi	Vlerësimi për nen standarde
Standard i plotë (6.77 % në pajtueshmëri)	Kërkesat e qasjes janë pjesë përbërëse e projekteve ndërtimore që nga faza e projektimit
Standard i adresuar pjesërisht (79.67% pjesërisht në pajtueshmëri)	Qasja e barabartë në mjedis fizik, transport, TIK dhe lehtësira dhe shërbime të tjera (legjislacioni nuk specifikon sigurimin e qasjes në zona rurale dhe natyrore)
	Standardet minimale dhe udhëzimet e qasjes (nuk përmenden shërbimet shtesë, për shembull, pajisje audio për personat me shikim të dobësuar, dhe ai i referohet vetëm një grupi dhe gjuhë shenjash)
	Kompanitë private heqin pengesat dhe nuk krijojnë pengesa të reja (përmendet numri i kufizuar i të drejtave, siç është lëvizja nëpër objekte, duke mos bërë asnjë referencë për shërbime të tjera thelbësore)
	Mekanizmat në dispozicion në rastet e mohimit të qasjes (e vetmja vegël ligjore në dispozicion është ankesa)
	Trajnimi i palëve të interesuara relevante për qasjen e personave me aftësi të kufizuara (nuk përmendet trajnimi i profesionistëve dhe sjellja e tyre karshi personave me aftësi të kufizuara, p.sh. zotësia e profesionistëve shëndetësorë për përdorimin e gjuhës së shenjave)
	Format për lehtësimin e komunikimit përmes Braille-it dhe udhëzuesve të tjerë (interpretët) (nuk përmendet e drejta e përdorimit të Braille-it në institucionet private)
	Qasja në informacion, sisteme, internet (pa përmendur në veçanti shërbimet e internetit, vetëm telefoni)
	Qasja e barabartë në mjedis fizik, transport, TIK dhe lehtësira dhe shërbime të tjera (legjislacioni nuk specifikon sigurimin e qasjes në zona rurale dhe natyrore)
Standardi që mungon (13.55% mungojnë)	Organizatat e personave me aftësi të kufizuara konsultohen lidhur me standardet dhe normat e qasjes

4.4. Arsimi

Arsimit ka përqindjen më të ulët të vlerësimit të standardit që mungon (me vetëm .33%) në mesin e dhjetë kategorive.

Standardet e Vlerësuara	ARSIMI
Vlerësimi	Vlerësimi për nen standarde
Standard i plotë (41.66% në pajtueshmëri)	E drejta për arsim gjithëpërfshirës
	Parandalimi i mohimit të së drejtës së arsimit në bazë të aftësisë / aftësisë së kufizuar
	Nxënësit me aftësi të kufizuara ndjekin mësim të rregullta në shkollë
	Detyrimet e shkollave për të përmirësuar qasjen për nxënësit e shkollës me aftësi të kufizuara
	Parandalimi i diskriminimit të vajzave me aftësi të kufizuara në qasjen në arsim
Standard i adresuar pjesërisht (50% pjesërisht në pajtueshmëri)	Parandalimi i diskriminimit të vajzave me aftësi të kufizuara në qasjen në arsim (nuk përmendet në veçanti mbrojtja e vajzave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi në arsim)
	Mbështetja individuale për nxënësit dhe studentët (nuk përmenden të gjitha nevojat e këtyre personave)
	Punësimi i mësuesve (duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara) që zotërojnë gjuhën e shenjave dhe gjuhën Braille (nuk përmenden personat me aftësi të kufizuara si të kualifikueshëm për punësim)
	Trajnimi i mësuesve dhe profesionistëve të tjerë për arsim gjithëpërfshirës (nuk përmenden në veçanti shkathtësitë të cilat duhen zotëruar pas trajnimeve)
Standardi që mungon (8.33 % mungojnë)	Parandalimi i diskriminimit të vajzave me aftësi të kufizuara në qasjen në arsim

4.5. Liria, mbrojtja nga torturat, integriteti dhe lëvizshmëria

Liria, mbrojtja nga torturat, integriteti dhe lëvizshmëria janë kategoria me vlerësimin më të lartë në këtë studim, ku pjesa më e madhe e detyrimeve (68.42%) cilësohet si "Standard i plotë".

Standardet e Vlerësuara	Liria, mbrojtja nga torturat, integriteti dhe lëvizshmëria
Vlerësim	<i>Vlerësimi për nen standarde</i>
Standard i plotë (68.42 % në pajtueshmëri)	Liria dhe siguria zbatohen mbi baza të barabarta me të tjerët
	Parandalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor
	Personat me aftësi të kufizuara nuk do t'i nënshtrohet eksperimenteve mjekësore apo shkencore pa pëlqimin e tyre
	Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi brenda dhe jashtë shtetësisë
	Respektimi i integritetit fizik dhe mendor të personave me aftësi të kufizuara mbi bazë të barabartë me të tjerët
	E drejta për nënshtetësi dhe mos privimi nga shtetësia në bazë të aftësisë së kufizuar
Standardi që mungon (31.58% mungojnë)	Parandalimi i palëve të treta (duke përfshirë anëtarët e familjes) nga institucionalizimi i personave me aftësi të kufizuara mbi bazën e aftësisë së kufizuar
	Kompensimi për personat me aftësi të kufizuara të privuar nga liria në bazë të aftësisë së kufizuar
	Akomodimi i arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara të privuar ligjërisht nga liria
	Mbrojtja përkitazi me moshën dhe gjininë për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet / ndihmësit
	Monitorim efektiv i të gjitha lehtësirave dhe programeve që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara nga autoritetet e pavarura
	Rehabilitimi fizik, kognitiv dhe psikologjik dhe riintegrimi shoqëror i personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë vuajtur a buzime

4.6. Barazia, mos diskriminimi (gratë dhe fëmijët)

Barazia, mos diskriminimi (gratë dhe fëmijët) si një nga kategoritë e rëndësishme përfshin detyrime që lidhen drejtpërdrejt me gratë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Në përgjithësi, kategoria shënon rezultat të moderuar me 60% të detyrimeve të integruara plotësisht në legjislacionin e Kosovës, ndërsa 40% e tyre mungojnë.

Standardet e Vlerësuara	Barazia, mos diskriminimi (gratë dhe fëmijët)
Vlerësim	<i>Vlerësimi për nen standarde</i>
Standard i plotë (60% në pajtueshmëri)	Liria, siguria dhe autonomia e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara
	Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në zhvillimin e politikave të aftësisë së kufizuar
	Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk do t'i nënshtrohen shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit
	E drejta për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara
	E drejta për shërbime shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara
	Regjistrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara menjëherë pas lindjes
Standard i adresuar pjesërisht (40% pjesërisht në pajtueshmëri)	Ndalimi i të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara (no të kufizuara)
	Heqja e barrierave në zhvillimin ekonomik dhe personal të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara (nuk përmendet në veçanti fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara)
	Qasja e garantuar në shërbime shëndetësore për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara (nuk përmenden shërbimet shtesë, p.sh. identifikimi dhe monitorimi i rasteve, sistemi i informacionit shëndetësor)
	Pjesëmarrja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitete sportive dhe rekreative (pa shpalosje të hollësishme të karakteristikave kulturore-individuale, si dhe të funksioneve të objekteve dhe hapësirave rekreative)

4.7. Shëndeti

Shëndeti vlerësohen pozitivisht, duke zënë vendin e dytë në mesin e dhjetë kategorive, ku 66.66% e detyrimeve cilësohen si "Standard i plotë". Një e treta e mbetur adresohet pjesërisht (8.33%) dhe si standard që mungon (25%).

Standardet e Vlerësuara	Shëndeti
Vlerësim	<i>Vlerësimi për nen standarde</i>
Standard i plotë (66.66 % në pajtueshmëri)	Objektet dhe shërbimet shëndetësore funksionale me programe dhe shërbime të përshtatshme për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara
	Objektet dhe shërbimet shëndetësore të qasshme dhe jo diskriminuese ndaj grupeve të pa favorizuara
	Shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara janë të përballueshme
	Shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara ofrohen mbi parimet etike dhe me respektimin e plotë të kulturës së individit, minoriteteve, popujve dhe komuniteteve, gjinisë dhe të tjera
	Të gjithë personat me aftësi të kufizuara në nevojë duhet të kenë qasje në shërbimet e rehabilitimit
	Personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre marrin pjesë në zhvillimin dhe organizimin e programeve dhe shërbimeve të rehabilitimit
Standard i adresuar pjesërisht (8.33 % pjesërisht në pajtueshmëri)	Shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara ofrohen me cilësi adekuate shkencore dhe mjekësore, si dhe me sasi përkatëse (mungojnë specifikat sa i përket sasisë përkatëse e cila duhet ofruar)
Standardi që mungon (25 % mungojnë)	Zhvillimi i programeve rehabilituese për të gjitha grupet e aftësisë së kufizuar
	Shërbimet e rehabilitimit ofrohen në komunitetin lokal ku jeton personi me aftësi të kufizuara
	Zhvillimi dhe vlerësimi i programeve të rehabilitimit merr parasysh ekspertizën e ofruar nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara

4.8. Punësimi dhe kujdesi social

Punësimi dhe kujdesi social është ndër kategoritë me performancë të moderuar, me vetëm 38.88% të detyrimeve (standardeve) ndërkombëtare të integruara plotësisht në legjislacionin e Kosovës.

Standardet e Vlerësuara	Punësimi dhe kujdesi social
Vlerësim	<i>Vlerësimi për nen standarde</i>
Standard i plotë (38.88 % në pajtueshmëri)	E drejta për të fituar të ardhura për jetesë nga një punë që u siguron qasje personave me aftësi të kufizuara
	Ndalimi i diskriminimit në punësim në bazë të aftësisë së kufizuar
	Qasja efektive e personave me aftësi të kufizuara në programet e arsimit profesional, mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e karrierës
	Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat
	Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga puna e detyruar
	Garantimi i standardit adekuat të jetesës për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre (ushqim, veshmbathje, strehim)
Standard i adresuar pjesërisht (44.45% pjesërisht në pajtueshmëri)	Mundësitë e barabarta në kushte të punës, pagesë, karrierë dhe mbrojtje nga ngacmimi (legjislacioni përqendrohet ngushtë në ngacmime në vendin e punës)
	Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet e ujit të pijshëm (nuk përmendet në veçanti e drejta e personave me aftësi të kufizuara për ujë të pijshëm)
	Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht e grave, vajzave dhe e të moshuarve me aftësi të kufizuara, në programet e përkujdesjes sociale dhe zbutjes së varfërisë (nuk përmenden në veçanti gratë dhe të moshuarit)
	Mbështetja financiare dhe shërbimet e tjera për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e varfra (nuk përmenden në veçanti personat me aftësi të kufizuara)
	Qasja e personave me aftësi të kufizuara në programet e strehimit social (nuk përmenden të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara)
	Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në programet e pensionit dhe benefitet
Standardi që mungon (16.66% mungojnë)	Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht e grave, vajzave dhe e të moshuarve me aftësi të kufizuara, në programet e përkujdesjes sociale dhe zbutjes së varfërisë

4.9. Pjesëmarrja publike

Ne kategorinë e **Pjesëmarrjes publike**, 60%, standardeve mungojnë. Kjo është njëra nga dy kategoritë me vlerësimin më të ulët. Në kategorinë e Pjesëmarrjes publike, standardet e mëposhtme janë integruar plotësisht ose pjesërisht në legjislacionin e Kosovës:

Standardet e Vlerësuara	Pjesëmarrja publike
Vlerësim	<i>Vlerësimi për nen standarde</i>
Standard i plotë (40 % në pajtueshmëri)	Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e jetës politike dhe publike mbi baza të barabarta me të tjerët (e drejta e votës dhe e zgjedhjes)
	Qasjes së personave me aftësi të kufizuara në materialin kulturor (legjislacioni në fuqi siguron qasjen e personave me aftësi të kufizuara në materialin kulturor vetëm në kushte të kufizuara)
Standardi që mungon (60% mungojnë)	Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë mjedis mbështetës për pjesëmarrje të plotë dhe jo diskriminuese në punët publike
	Qasja e personave me aftësi të kufizuara në programe televizive, filma, teatër dhe aktivitete të tjera kulturore
	Qasja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet dhe monumentet e trashëgimisë kulturore

4.10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Në **Statistika dhe bashkëpunim ndërkombëtar**, të gjitha standardet e vlerësuara mungojnë në legjislacionin e Kosovës:

Standardet e Vlerësuara	Statistikave dhe Bashkëpunimit ndërkombëtar
Vlerësim	<i>Vlerësimi për nen standarde</i>
Standardi që mungon (100 % mungojnë)	Mbledhja, analizimi dhe publikimi i të dhënave statistikore mbi gjendjen e personave me aftësi të kufizuara
	Programet e zhvillimit ndërkombëtar janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara
	Sigurimi i mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve përmes ndarjes dhe shkëmbimit të informacionit, trajnimit dhe praktikave më të mira
	Lehtësimi i bashkëpunimit në hulumtime dhe qasja në njohuritë shkencore dhe teknike

Ashtu siç mund të shihet më lartë, Në dy kategoritë e fundit, **Pjesëmarrja publike dhe Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar**, 60%, përkatësisht 100% e standardeve mungojnë. Këto mbesin si dy kategoritë me vlerësimin më të ulët.

5. Konkluzione dhe Rekomandime

HANDIKOS, Shoqata e Kosovare e të Shurdhërve, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Disability Partnership Finland, Threshold, Forumi Kosovar për Aftësinë e Kufizuar dhe Zyra për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit, janë duke iniciuar procesin e vlerësimit sistematik të gjendjes së legjislacionit të aftësisë së kufizuar në Kosovë në raport me standardet ndërkombëtare (OKB dhe BE), duke i ftuar institucionet shtetërore në një dialog të strukturuar dhe afatgjatë që synon ti jap forme politikave të aftësisë së kufizuar, duke u bazuar në hulumtime dhe prova. Prandaj, rekomandimet e mëposhtme të këtij raporti synojnë institucionet kryesore qeverisëse dhe të legjislativitetit, duke i nxitur ata të ndërmarrin hapa për integrimin e standardeve ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar, ashtu siç përshkruhet në KDPAK, Acquis Communautaire të BE-së dhe dokumente të tjera të rëndësishme.

Rekomandimi 1: Kjo pasqyre nxitë Parlamentin e ri të Kosovës dhe Qeverinë e re të krijojë një sistem kombëtar të vlerësimit të standardeve të aftësisë së kufizuar. Sistemi do të vlerësonte të dyja, legjislacionin dhe zbatimin e tij dhe do të shërbejë si përshpejtues i zhvillimit të politikave dhe proceseve të ofrimit të shërbimeve. Shoqëria civile duhet të jetë pjesë integrale e të gjithë procesit, pasi ky është një nga standardet kryesore ndërkombëtare për aftësinë e kufizuar. Në të njëjtën kohë, organizatat e shoqërisë civile inkurajohen të japin raportin paralele 'raporte nën hije', si një pasqyrim objektiv i vlerësimit të shtetit.

Rekomandimi 2: Institucionet e Kosovës duhet të adresojnë të gjitha fushat përkatëse të të drejtave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar, meqenëse ka boshllëqe të konsiderueshme ligjore. Në këtë drejtim, të dhjetë kategoritë e standardeve të aftësisë së kufizuar të vlerësuara në këtë raport, duhet të jenë fusha me prioritet për institucionet shtetërore. Sidoqoftë, disa kategori kërkojnë ndërhyrje urgjente, për shkak të rezultateve alarmante dhe të ulëta të vlerësimit. Këto përfshijnë kategoritë e qasjes, pjesëmarrjen e publikut, statistikën, të drejtën e jetës dhe drejtësisë, pavarësinë, privatësinë, familjen dhe jetën në komunitet, punësimin dhe kujdesin shoqëror. Standardet që mungojnë si pjesë e kategorive përkatëse, të paraqitura në detaje në pjesën e mëparshme, janë një thirrje urgjente për institucionet shtetërore.

Rekomandimi 3: Rreth 70% të standardeve ndërkombëtare mungojnë ose janë pjesërisht të përfshira apo/dhe të integruara në legjislacionin e Kosovës. Institucionet e Kosovës duhet të përmirësojnë legjislacionin ekzistues të aftësisë së kufizuar sipas standardeve ndërkombëtare, duke u mundësuar personave me aftësi të kufizuara të gëzojnë dhe ushtrojnë plotësisht të drejtat dhe shërbimet përkatëse. Duhet të theksohet se, edhe kur legjislacioni përfshin standardet ndërkombëtare, sipas raporteve të shumta të vlerësimit, zbatimi i tyre shpesh është i varfër apo mungon (megjithëse vlerësimi i zbatimit të këtij legjislacioni, është përtej qëllimit të këtij studimi).

Rekomandimi 4: Vlerësimi i standardeve të aftësisë së kufizuar (të drejtat dhe shërbimet) në Kosovë duhet të analizojë edhe zbatimin, përveç përfshirjes së standardeve përkatëse në legjislacionin vendor. Ky përbën një hap të madh dhe kompleks që kërkon përfshirjen e të gjitha palëve relevante. Andaj, institucionet shtetërore në bashkëpunim me organizatat e personave me aftësi të kufizuar, institutet e specializuara kërkimore, dhe me mbështetjen shtesë të donatoreve të bashkësisë ndërkombëtare, duhet që deri në vitin 2020 të avancojnë metodologjinë dhe të zgjerojnë qëllimin për një vlerësim gjithëpërfshirës të standardeve të aftësisë së kufizuar (si në legjislacion ashtu edhe tek zbatimi). Këshilli Nacional i Aftësisë së Kufizuar konsiderohet si mekanizmi më i mirë për të rimarrë këtë mandat. Ndërsa Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit, si një nga mekanizmat kryesorë i qeverisë përgjegjës për të koordinuar dhe monitoruar zbatimin e strategjisë së aftësisë së kufizuar, së bashku me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara, të funksionojnë si sekretariati i Këshillit Nacional të Aftësisë së Kufizuar dhe të krijojnë një sistem për monitorimin e zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive për personat me aftësi të kufizuara bazuar në të dhëna dhe statistika.

Rekomandimi 5: Kuvendi i Kosovës bëri një hap të rëndësishëm me integrimin e QZHQ-ve (Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm) në agjendën e zhvillimit kombëtar të vendit. Aftësia e kufizuar përmendet në pjesë të ndryshme të QZHQ-ve dhe posaçërisht në pjesë që lidhen me arsimin, rritjen dhe punësimin, pabarazinë, qasjen e vendbanimeve, si dhe mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e QZHQ-ve. Të gjitha raportet e ardhshme të vlerësimit duhet të vlerësojnë edhe progresin kundrejt treguesve të QZHQ-ve.

Rekomandimi 6: Njëra prej mënyrave për të lëvizur përpara drejt instalimit të një instrumenti sistematik që do të përfshinte standardet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar në legjislacionin dhe praktikën e Kosovës është ratifikimi i KDPAK nga Kuvendi i Kosovës. Kësisoj, institucionet do të kishin një kornizë të konsoliduar për t'i udhëhequr proceset e tyre të zhvillimit të politikave, si dhe vlerësimin e legjislacionit dhe zbatimin e tij (duke u bazuar në instrumentet që propozon Konventa).

Së fundmi, ky raport dhe raportet që do të përgatiten në vitet e ardhshme duhet të përdoren për zhvillimin e politikave dhe proceseve të arritshmërisë. Qëllimi kryesor i këtij raporti është të nxjerrë në pah boshllëqet në legjislacion dhe t'i udhëzojë institucionet shtetërore për planifikimin, hartimin dhe shpërndarjen e duhur të politikave publike për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Funded by the European Union
Financuar nga Bashkimi Evropian
Finansira Evropska Unija



European
Union
Kosovo

